



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
GJIROKASTËR

ANALIZA VJETORE E PROKURORISE SE RRETHIT GJYQESOR
GJIROKASTER PËR VITIN 2015


Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Gjirokastër, duke zbatuar kërkesat e legjislacionit penal dhe procedural penal, urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që normojnë punën, si organ i procedimit penal ka përmbushur për periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2015, detyrat në fazat e hetimeve paraprake, të gjykimit, të ekzekutimit të vendimeve penale.

Zyra e Rregjistrimit prane se Prokurorisë Prane Gjykates se Shkalles Gjirokastër për periudhën 01.01.2015-31.12.2015, ka evidentuar te rregjistruara 859 procedime penale me 184 persona nën hetim, 321 te pandehur, me 104 persona te hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Kane ardhur nga Prokurori te tjera per kompetence 108 procedime penale, me dy persona nën hetim, 06 te pandehur, nga te cilet 05 te pandehur me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Pra, ne total jane rregjistruar gjate vitit 2015, 967 procedime penale, me 186 persona nën hetim, 327 te pandehur nga te cilet 109 te hetuar me mase sigurimi personal “arrest ne burg”.

Tabela e regjistrimeve të reja për vitin 2014 dhe 2015



	Gjithësej regjistruar	Persona nën hetim	Pandehur	Masë sigurimi arest në burg	Mbartur nga viti paraardhës
Viti 2014	937	202	360	226	119
viti 2015	967	186	327	109	253


Jane mbartur nga viti 2014 per vitin 2015, 253 procedime penale me gjithsej 32 persona nen hetim, 134 te pandehur nga te cilet 69 prej tyre me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Eshte marre vendim per mosfillimin e procedimit penal per 390 materiale kallzuese

Nuk eshte regjistruar asnje veper penale e parashikuar nga K.P.Ushtarak.

Ne total per vitin 2015 nga ana e kesaj prokurorie jane hetuar 1220 procedime penale, me 218 persona nen hetim, 461 te pandehur, nga te cilet 178 hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg”


Tabela procedimeve gjithsej gjatë 2014 dhe 2015



	Gjithsej hetuar gjatë vitit	Persona nën hetim	Pandehur	Masë sigurimi arrest në burg
Viti 2014	1057	234	419	251
viti 2015	1220	218	461	178

Nga tërësia e procedimeve penale për të cilat është ushtruar ndjekja penale për vitin 2015, kanë përfunduar hetimet paraprake dhe u është dhënë zgjidhje ligjore, brenda vitit 2015 një total prej 883 procedime penale, me 107 persona nën hetim, 461 të pandehur nga të cilët 148 me masë sigurimi “Arrest në burg”.


Tabela procedimeve të përfunduara gjatë 2014 dhe 2015




	Përfunduar	Persona nën hetim	Pandehur	Masë sigurimi arrest në burg
Viti 2014	772	108	432	200
viti 2015	883	107	461	148

Jane mbartur ne hetim, per vitin 2016 nje total prej 337 procedime penale, me 112 persona nen hetim, nga te cilet 30 prej tyre hetohen me mase sigurimi personal “Arrest ne burg”.

Është vendosur dërgimi në gjyq për 393 procedime penale, me totalin prej 461 te pandehur, nga te cilet 146 kane qene me mase sigurimi “Arrest ne burg”.



Jane gjykuar 199 procedime penale me gjithesej 220 te pandehur nga te cilet 54 jane me mase sigurimi personal “arrest ne burg”.




Mbeten ne gjykim 194 procedime penale, me 244 te pandehur, nga te cilet 103 te pandehur jane me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Nga procedimet e mesiperme 193 prej tyre jane gjykuar me procedure te gjykimit te shkurtuar, me 229 te pandehur , 4 procedime penale me 10 te pandehur jane proceduar me gjykim te zakonshem, dhe kemi 02 raste te gjykimit te drejtperdrejte me 02 te pandehur.



Nga ana e prokurorit per 44 te pandehur eshte kerkuar denimi me gjobe, per 138 te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim(*mesatar*) ,per 57 te pandehur nga ana e prokurorit eshte kerkuar pezullimi i ekzekutimit te vendimit te gjykates, kurse per nje te pandehur eshte kerkuar pushimi i akuzes per shkak te amnistise.



Ne diskutim perfundimtar nga ana e perfaqesuesit te prokurorise eshte kerkuar kryesisht denimi me gjobe per veprat penale:-“ *Kalim i paligjshem i kufirit*”, “*Kontrabande me mallrat e tjere*”, “*Perdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike*”

Nga ana e gjykates per 44 te pandehur eshte vendosur denimi me gjobe sipas kerkeses se prokurorit , denim mesatar me burgim ka vendosur per 135 te pandehur, per dy te pandehur ka vendosur denimin ne minimum, nenin 59 e ka aplikuar per 57 te pandehur , kurse per nje rast ka vendosur pushim akuze dhe nje pafajesi.

Eshte vendosur pushimi i hetimit per 131 ceshtje penale me 71 persona nen hetim, asnje prej nuk ka patur statusin e te pandehurit, asnje nga personat e mesiperm nuk eshte hetuar me mase sigurimi personal “arrest ne burg”.

Nga procedimet e mesiperme penale,per 13 persona nen hetim procedimet jane pushuar me arsyetimin “Per shkaqe te tjera”, ku perfshihet Ligji per Amnistine, ketu perfshihet edhe heqja dore nga i demtuari akuzues, pa te arrestuar ; jane pushuar hetimet per 38 persona per mungese provash , nuk ka patur asnje rast te personave te hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg”, jane pushuar 20 procedime penale me arsyetimin ligjor “mungese fakti”, me 20 persona nen hetim, asnje me mase sigurimi arrest ne burg.

Gjate vitit 2015 jane pezulluar 321 ceshtje penale, me 06 persona nen hetim, asnje prej tyre me mase sigurimi “Arrest ne burg”.Per nje ceshtje eshte vendosur pezullimi i hetimit per shkak te gjendjes shendetesore te te pandehurit.


Jane transferuar ne prokurori te tjera duke u shpallur moskompetenca 38 ceshtje penale me 30 person nen hetim nga te cilet 02 me mase sigurimi “arrest ne burg”(Prokurorise se Krimeve te Renda).

Kryesisht eshte shpallur moskompetenca per procedime penale te cilat jane rregjistruar per vepren penale:-“Kalim i paligjshem i kufirit”.

Sikurse u theksua gjate vitit 2015 kane qene nen hetim 218 persona nen hetim + 461 te pandehur **totali prej 679 personash**, me total prej 178 personash te hetuar me mase sigurimi “Arrest ne burg”.

Me arsim deri ne 09 klase jane 389 persona, te mesem 246 dhe me arsim te larte 44.Nga keta 01 shtetas i huaj dhe nga totali i personave nen hetim 33 jane te seksit femer, nga te cilat 03 jane te mitura dhe 30-te madhore.Te punesuar ne sektorin privat jane 114 persona, nenpunes te thjeshte jane 16 persona,pjesa tjeter prej 549 persona jane te papune. Nga personat e mesiperm 227 persona rezultojne me banim ne qytet dhe 401 rezultojne me banim ne komuna.


Të pandehur sipas arsimimit viti 2014 dhe viti 2015



	Arsimi 9 klase	Arsimii mesem	Arsimi I larte
Viti 2014	339	251	59
Viti 2015	389	246	44

Nga totali i pergjithshem rezultojne te denuar recidiviste 38 te pandehur, kryesisht per vepren penale te vjedhjes se pasurise, perserites per vepra te ndryshme penale jane 35 autore te veprave penale, pjesa tjeter prej 606 personash te proceduar penalisht rezultojne te padenuar me pare.

Të pendehur sipas punësimit viti 2014 dhe 2015



	Sektori privat	Nënpunës thjeshte	Papune
Viti 2014	152	30	466
Viti 2015	114	16	549

Nga numri i personave te hetuar ne total prej 679 personash te proceduar, 57 persona jane te mitur, madhore mbi 18 vjec jane 622 persona.

Per te patur nje ide me te qarte mbi sa u pershkrua me siper, si edhe mbi raportin e ceshtjeve te derguara ne gjykim , pezulluara dhe pushuara, po ricitojme se ne total jane hetuar 1220 procedime penale(bashke me procedimet e mbartura te vitit 2014)gjate vitit 2015 dhe nga keto procedime 393 jane derguar ne gjykim, 321 jane pezulluar, 131 jane pushuar , 38 jane transferuar dhe 337 procedime penale jane mbartuar ne hetim per vitin 2016

Rezulton se numri i ceshtjeve te derguara per gjykim eshte dukshem me i larte se numri i ceshtjeve te pezulluara dhe eshte tentuar te ulet numri i ceshtjeve te pushuara, duke zene ne total numri ceshtjeve te pushuara afersisht 10% te numrit te pergjithshem te procedimeve te hetuara nga kjo prokurori.Kjo tregon per rritje te cilesise se hetimit, duke filluar me hetimin paraprak te kryer nga o.p.gjyqesore te Drejtorise se Policise se Qarkut Gjirokaster, por edhe me kontrollin rigoroz te ushtruar nga prokuroret mbi ceshtjet ne hetim.

Nga ceshtjet e shqyrtuara ne Gjykatën e Shkalles se Pare Gjirokaster per vendimet e themelit te marra nga kjo gjykate, jane apeluar nga perfaqesuesi i prokurorise ne total 24 vendime themeli, nga te cilet 08 vendime per pafajesi, 03 per pushim ceshtje dhe 13 vendime themeli per mase denimi me te bute.

Nga 11 apelime te Prokurorise qe kane te bejne me masen e denimit te dhene nga gjykata, Gjykata e Apelit ne 6 raste ka pranuar apelimin duke pranuar kerkesen e prokurorit, per kater raste ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare dhe ne nje rast ka vendosur pushimin e ceshtjes.


Nga kerkesate prokurorit per vendimet e pafajesise te dhena nga Gjykata e Shkalles se Pare Gjirokaster, Gjykata e Apelit ne 05 raste ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit te gjykates se Shkalles se Pare dhe ne nje rast ka vendosur fajesi, nje rast ka vendosur kthimin e ceshtjes per rigjykim.

Ne lidhje me masat e sigurimit te dhena nga Gjykata e Shkalles se Pare Gjirokaster, nga ana e perfaqesuesit te Prokurorise jane ushtruar 15 apelime, nga te cilat per 03 raste Gjykata e Apelit ka pranuar apelimin duke vendosur mase sigurimi “Arrest ne burg”, sipas kerkeses se prokurorit dhe ne 7 raste ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare.

Në një referencë të tillë ndarja e veprave penale, të pandehurëve dhe mënyrës të zgjidhjes përfundimtare të procedimeve të rregjistruara dhe atyre të mbartura për vitin 2014, rezulton si më poshtë:-

KRIMET KUNDËR PERSONIT

Nga tërësia e procedimeve penale, të regjistruara gjatë vitit 2015, evidentohen **81** procedime penale të regjistruara për vepra penale kundër personit, **kreu II** Seksionet I; III;VI;VII;VIII;IX :X te K.Penal, me 30 persona nen hetim, 33 te pandehur, nga te cilet 15 me mase sigurimi arrest ne burg. Te mbartura nga viti 2014 jane 16 procedime penale me 04 nen hetim dhe 11 te pandehur nga te cilet 03 me mase sigurimi arrest ne burg.



Pra konstatohet nje rritje e numrit te veprave penale nga viti i kaluar me me 05 vepra penale me teper.


Jane pushuar 25 procedime , jane pezulluar 06 ceshtje, transferuar 02 ceshtje dhe jane derguar per gjykim 40 procedime penale me 44 te pandehur nga te cilet 11 me mase sigurimi arrest ne burg.Jane gjykuar 16 procedime me gjykim te shkurtuar me total 18 te pandehur.Nuk ka pafajesi per keto figura veprash penale.

Vlen te theksohet se i eshte dhene vleresim kundervajtjes penale “ Plagosje e lehte”, parashikuar nga neni 89 K.Penal, per te cilen gjate vitit 2014 jane hetuar 12 raste .

Po keshtu i eshte kushtuar vemendje e vecante vepres penale :-“ Dhune ne familje”, parashikuar nga neni 130/a e Kodit Penal. Gjate vitit 2015 jane regjistruar 30 procedime, me 10 nen hetim, 19 te pandehur, nga te cilet 6 me mase sigurimi “arrest ne burg”. Kane shkuar per gjykim 19 procedime me 21 te pandehur nga te cilet 04 me mase sigurimi “arrest ne burg”.Ka perfunduar gjykimi per 02 te pandehur dhe per te gjithë eshte kerkuar denimi me burgim.Nga ana e gjykates jane pranuar kerkesat e prokurorise dhe nuk ka raste pafajesie.

VEPRA PENALE TE KRYERA KUNDER PASURISE DHE NE SFEREN EKONOMIKE

Jane rregjistruar **345** procedime të regjistruara për vepra penale të kryera kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, **Kreu III** seksionet I; II; III; V; VI; VII ;VIII ; X; XI; të K.Penal; me 40 persona nën hetim , 98 të pandehur, nga të cilët 48 me masë sigurimi arrest në burg. Jane mbartur nga viti 2014 gjithsej 85 procedime penale me 14 persona nën hetim 37 të pandehur, nga të cilët 15 me masë sigurimi arrest në burg.



Ne total jane hetuar 430 procedime penale, me 54 persona nën hetim, 135 të pandehur, nga të cilët 63 me masë sigurimi “arrest në burg”

Konkretisht në lidhje me veprën penale të vjedhjes pasurisë , parashikuar nga neni 134 K.Penal, janë rregjistruar 233 procedime penale, me 20 persona nën hetim, 56 të pandehur, nga të cilët 40 me masë sigurimi “arrest në burg”. Duke marrë në raport numrin e çështjeve me atë të personave të evidentuar si autorë të kësaj vepre penale, konstatohet se ka zbulueshmeri të ulët çka tregon se duhet të kushtohet vëmendje hetimit të kësaj figure të vepres penale.

Njekoherisht konstatohet se autorë të vepres penale të vjedhjes janë 18 të mitur.

Duke marrë në konsideratë shkallën e përhapjes së kësaj vepre penale në njësine administrative që mbulon kjo prokurori, duhet theksuar se është ashpersuar relativisht politika e denimit. Por, është mbajtur parasysh fakti se numri i personave të evidentuar si autorë të kësaj figure krimi janë të papunë dhe 54 persona nga totali prej 76 të pandehur janë me arsim deri në 9 klase dhe krejtësisht pa të ardhura.

Jane pushuar 05 çështje për mungesë provash me një person nën hetim, janë pezulluar 134 çështje me dy persona nën hetim , pa masë sigurimi, për të cilët është bërë pushim i pjesëshëm i hetimit, për mungesë provash dhe janë dërguar gjyqit 49 procedime me 56 të pandehur nga të cilët 31 me masë sigurimi “arrest në burg”.

Jane gjykuar 16 procedime penale me 19 te pandehur, te gjitha me gjykim te shkurtuar. Nuk ka pafajesi. Vendimet e gjykates ne pergjithesi kane qene ne perputhje me kerkesen e prokurorit te seances.

Ne lidhje me vepren penale :-“ Vjedhje energjiqe elektrike”, parashikuar nga neni 137 K.Penal, jane rregjistruar 11 procedime penale, me 05 nen hetim, 05 te pandehur, nga te cilet 02 me mase sigurimi “arrest ne burg”.Jane derguar per gjykim 08 ceshtje, me 08 te pandehur, nga te cilet 03 me mase “arrest ne burg”.Jane mbartur nga viti 2014 08 procedime penale me 6 prsona nen hetim ,nje person i pandehur me mase sigurimi arrest ne burg. Jane gjykuar me gjykim te shkurtuar 04 ceshtje me kater te pandehur, per te 04 eshte deklaruar fajesi.Kjo veper penale nuk ka patur shkalle te madhe perhapjes ne njesine tone administrative.


Ne lidhje me vepren penale te “ Organizmit te llotarive”, parashikuar nga neni 197 i K.Penal jane rregjistruar 09 procedime me 04 nen hetim dhe 04 te pandehur.Jane derguar per gjykim 04 procedime me 04 te pandehur, jane gjykuar 01 procedime me 01 i cili eshte deklaruar fajtor dhe eshte denuar me gjobe.Jane pushuar 03 procedime per mungese prove.

VEPRA PENALE KUNDER MJEDISIT

Jane rregjistruar **06** procedime për vepra penale kundër mjedisit Kreu **IV**;

VEPRA PENALE KUNDER AUTORITETIT TE SHKETIT

Jane rregjistruar 414 procedime penale për vepra penale kundër autoritetit të shtetit,, Kreu **VIII** Seksionet I;II;III;IV; me 113 persona nen hetim, 186 te pandehur, nga te cilet 38 me mase sigurimi arrest ne burg. Mbartur nga viti 2014 ,143 procedime penale me 14 persona nen hetim, 82 te pandehur , nga te cilet 50 me mase sigurimi arrest ne burg. Kane ardhur per kopetence nga Prokurorite e tjera 107 procedime penale me 2 persona nen hetim, kater te pandehur nga te cilet 3 me mase sigurimi arrest ne burg.



Jane pushuar gjithesej 49 procedime penale, 11 per mungese fakti, 22 per mungese provash dhe 13 per shkaqe te tjera.

Ketu perfshihet vepra penale e "Perdorimi me keqdashje te thirrjeve telefonike", parashikuar nga neni 275 K.Penal. Jane filluar mbi bazen e ankimit 24 procedime penale nga te cilat per 08 eshte vendosur pushimi pasi i demtuari akuzues e ka terhqur ankimin. Nisur nga praktika hetimore vlen te theksohet se ne lidhje me kete dispozite duhet te kete nje interpretim me i zgjeruar dhe te qartesohet se cfare duhet te konsiderohet "perdorim me keqdashje", pasi sikurse konstatohet rritet artificialisht numri i procedimeve te filluara dhe njekohesisht konstatohen raporte dhe meri personale midis ankuesve dhe te afermeve ose te njohurve te cilat nuk perbejne figure te vepres penale. Nese do te gjendej nje rregullim ligjor si psh abonenti te kerkonte tabulatet dhe kompania perkatese te kishte detyrimin ti vinte ne dispozicion, sigurisht keto akte do ti neneshtroheshin vleresimit paraprak te prokurorit dhe do bente te mundur vleresimin e faktit qysh ne fazen fillestare te paraqitjes se ankimit. Pra me qartesisht ankuesi duhet ta shoqeronte ankimin se bashku me tabulatet e thirrjeve telefonike.

Nga veprat penale te ketij kreu duhet te vecojme figuren e vepres penale:-

"Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve luftarake dhe municionit", parashikuar nga neni 278 i K.Penal. Jane regjistruar 16 procedime penale me 03 persona ne hetim, 03 te pandehur nga te cilet 02 me mase sigurimi arrest ne burg. Jane mbartur nga viti 2014 ,19 procedime penale me 01 person nen hetim, 8 persona te pandehur nga te cilet gjashte me mase sigurimi arrest ne burg. Kane ardhur per kompetence nga Prokuroria Per Krimet e Renda 88 procedime penale me dy persona nen hetim dhe nje te pandehur. Jane pezulluar 93 procedime penale per faktin se autori nuk dihet, jane derguar gjyqit 12 procedime penale me 15 te pandehur nga te cilet 11 me mase sigurimi arrest ne burg. Jane gjykuar me gjykim te shkrutuar 6 te pandehur nga te cilet 4 me mase sigurimi arrest ne burg. Te gjithete te pandehurit jane deklaruar fajtor.

" Prodhim dhe shitje e narkotikeve", parashikuar nga nenet 283/1 dhe 283/2 K.Penal.

Jane rregjistruar 23 procedime penale per vepren penale *" Prodhimit te narkotikeve"*, parashikuar nga neni 283/1 K.Penal, me 12 persona nen hetim, 03 te pandehur me 05 te hetuar me mase sigurimi arrest ne burg. Mbaruar 66 procedime me 02 persona nen hetim, 32 te pandehur, me 20 te hetuar me mase sigurimi "arrest ne burg". Kane ardhur per kompetence nga Prokurorite e tjera 18 procedime penale.

Jane pushuar 02 ceshtje me 02 persona nen hetim, per mungese provash.

Jane pezulluar 38 ceshtje dhe jane derguar per gjykim 34 procedime penale me 34 te pandehur me 22 te hetuar me mase sigurimi "arrest ne burg".

Jane gjykuar 24 procedime penale me gjykim te shkurtuar me 24 te pandehur per te cilet eshte kerkuar denim me burg dhe eshte pranuar nga gjykata. Nuk ka pafajesi.

Nga totali prej 49 autoresh te evidentuar, 37 jane me arsim deri ne 09 klase, 11 me arsim te mesem dhe 01 me arsim te larte. Nga ky total 43 prej tyre jane te papune dhe pa te ardhura.

Ne lidhje me vepren penale *" Prodhimi i narkotikeve"*, parashikuar nga neni 283/2 K.Penal jane rregjistruar 02 procedime me 02 nen hetim, 02 te pandehur, 01 hetuar me mase sigurimi "arrest ne burg". Eshte mbartur nga vitet 2014, 03 procedime me 01 person nen hetim ,08 te pandehur me mase sigurimi "arrest ne burg".

Eshte pushuar akuza per nje person nen hetim ne gjendje te lire, jane derguar ne gjyq 04 procedime me 10 te pandehur, 09 me mase sigurimi arrest ne burg. Jane gjykuar 02 ceshtje me 05 te pandehur me gjykim te shkurtuar, te gjitha deklaruar fajtor.

Nga totali prej 13 personash te evidentuar per kete veper penale 11 prej tyre jane te papune dhe 7 me arsim deri ne 09 klase.

Ne lidhje me vepren penale:-“ Kultivimi i bimeve narkotike”, parashikuar nga neni 284 K.Penal eshte evidentuar rritje e numrit te ceshtjeve te rregjistruara. Jane rregjistruar 100 procedime penale me 26 persona nen hetim, 02 te pandehur, me 10 persona te hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg. Jane derguar per gjykim 13 procedime me 13 te pandehur nga te cilet 07 me mase sigurimi arrest ne burg. Jane gjykuar me gjykim te shkurtuar 11 procedime me 11 te pandehur me 06 te pandehur me mase sigurimi arrest ne burg. Te gjitha te pandehurit jane deklaruar fajtor dhe Gjykata ka vendosur sipas kerkeses se Prokurorit.

-Vlen te theksohet edhe figura e vepres penale :-“Shkelje e rregullave te qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 K.Penal.

Jane rregjistruar 12 procedime penale per vepren penale te parashikuar nga neni 290 K.Penal me 06 persona nen hetim, 05 te pandehur, nga te cilet 03 me mase sigurimi “arrest ne burg”, eshte mbartuar 01 procedim me nje te pandehur , hetuar ne gjendje te lire.

Jane derguar ne gjykim 05 procedime me 06 te pandehur me 02 persona te hetuar me mase sigurimi arrest ne burg. Jane gjykuar 03 ceshtje me 03 te pandehur per te cilet gjykata ka deklaruar fajtesine mbi kerkesen e prokurorit. Jane pushuar 02 procedime penale me 02 persona nen hetim , per shkaqe te tjera per faktin se ka pasur nga nje plagosje te lehte. Masat e denimit relativisht kane qene te ashpra.


Problematike e perseritur ne hetimin e ketyre ceshtjeve ka qene dhe mbetet ekspertimi auto-teknik per te cilin ende nuk eshte gjetur zgjidhje e plote, por probleme jane shfaqur edhe me ekspertimet mjeko-ligjore sic jane mosberja e grafise se viktimave, venia ne dispozicion e akteve jo te plota ekspertit autoteknik.

Ne lidhje me vepren penale “ Drejtimi mjete ne menyre te parregullt”, parashikuar nga neni 291 K.Penal, jane rregjistruar 77 procedime penale me 03 persona nene hetim , 74 te pandehur te cilet jane derguar per gjykim. Jane gjykuar 44 ceshtje me 44 te pandehur dhe eshte kerkuar burg ne aplikim te nenit 59 te K.Penal.

VEPRA PENALE TE KRYERA KUNDER DREJTESISE

Jane rregjistruar 13 procedime penale per vepra penale te kryera kunder drejtësisë, kreu IX; me 01 person nen hetim , 04 te pandehur nga te cilet 03 me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Vepra penale te kryera kunder drejtesise



	Procedime	Persona nen hetim	Pandehur	Arrest ne burg
Viti 2014	6	3	1	1
Viti 2015	13	1	4	3

Pas studimit te statistikes se te dhenave te pergjitheshme te evidentuara per ceshtjet ne hetim prane kesaj prokurorie evidentohen disa karakteristika kryesore te autoreve te veprave penale.

-Jo cdo shtetas qe kryen veper penale eshte kriminel, pavaresisht nga lloji i krimit dhe ne keto rrethana duhet ndjekur politike denimi e diferencuar dhe e studiuar. I referohemi me se tepermi faktit te evidentuar tashme te kultivimit te bimeve narkotike. Rezulton se shume prej autoreve jane ne kufijte e deshperimit dhe mungeses se mirqenies.

-Te prirur per te kryer vepra penale jane personat pa arsim, me arsim te kufizuar deri ne nente klase dhe nje perqindje e ulet me arsim te mesem.

-Te prirur jane personat te cilet rezultojne me pak te ardhura ose pa asnje lloj te ardhure.

Sikurse rezulton ka nje ndarje te perafert te vendit te banimit te autoreve, pothuajse ne menyre te barabarte midis komunave dhe qytetit. Kjo edhe per shkak te levizjes demografike. Por rezulton qe per lloje te vecanta te veprave penale te kondicionohen nga ambienti sic mund te permendim veprën penale:- Kultivimi i bimeve narkotike.


Faktet e mesiperme por edhe te tjera rrethana na shtyn te arsyetojme se jo gjithmone ashpersimi i dispozitave te kodit penal do te sjelle pasoja pozitive ne uljen e kriminalitetit.

Nuk ka asnje prove bindese qe te na shtyje te mendojme se me ashpersimin e dispozites "Mbajtje pa leje e armeve luftarake dhe municionit" numri vrasjeve dhe krimeve qe shoqerohen me perdorimin e armes eshte pakesuar. Cenimi dhe ndryshimi periodik i Kodit Penal nuk ka sjelle rezultatet pozitive te priteshme.

Duke ju referuar dy faktoreve kryesore te evidentuar per autoret e veprave penale lehtesisht konkludohet se krimi nuk ulet duke u treguar agresiv ne zgjedhjen e mases se sigurimit "arrest ne burg", as duke ashpersuar politikaten e denimit. Duhet te kerkohet me teper zbatimi i denimeve alternative.

MASAT E SIGURIMIT

Për vitin 2015 se bashku me materialin kallzues kane ardhur **195** raste te arrestimit ne flagrance dhe **41** persona te ndaluar, pra ne total 236 persona. Ne tre raste eshte urdhruar lirimi i menjehershem nga prokurori. Jane paraqitur ne gjykate 233 kerkesa per vlefesim dhe nga gjykata jane vleresuar te ligjeshme arrestimet ne flagrance dhe ndalimet



Njekohesisht nga prokurori eshte kerkuar caktimi i mases sigurimit arrest ne burg per 105 persona te pranishem dhe 04 persona ne mungese, per 04 raste “arrest me afat”, per dy persona arrest ne shtepi, dhe per 121 persona “detyrim per paraqitje ne policine gjyqesore”.

Nga ana e gjykates per 99 persona eshte vlefesuar i ligjshem arresti ne flagrance/ndalimi dhe eshte vendosur “arrest ne burg”. Per 04 raste ka vendosur “arrest ne mungese”, per 04 persona ka vendosur “arrest me afat”, per 04 persona ka vendosur “arrest ne shtepi” dhe per 126 persona ka vendosur “detyrim per paraqitje ne policine gjyqesore”.

Nuk ka patur raste te kerkimit nga prokurori te Zv te mases se sigurimit nga “arrest ne burg” ne mase tjeter me te lehte.

Ne lidhje me masat e sigurimit jane ushtruar 15 apeline te cilat jane shqyrtuar ne Gjykatën e Apelit. Jane pranuar 03 apeline duke vendosur Gjykata e Apelit masen e sigurimit “arrest ne burg” sipas kerkeses se prokurorise 07 vendime jane lene ne fuqi dhe per pese apeline eshte hequr dore nga Prokurori i Apelit.

URDHËRAT E EKZEKUTIMIT

Në lidhje me urdhërat e ekzekutimit, nga ana e prokurorit të ekzekutimeve urdhërat janë nxjerrë në kohën e duhur dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 për "Për ekzekutimin e vendimeve penale" si dhe duke respektuar Urdhërat dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm në këtë drejtim.

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për vitin 2015 janë nxjerrë 367 Urdhëra për ekzekutim, nga të cilët 2 urdhëra që permbajnë denim me burgim të perjetshëm, 155 urdhëra për vendime që përmbajnë dënime me burgim, 84 urdhëra për vendime që përmbajnë dënime me gjobë dhe 126 denim me kusht, pra aplikimi i nenit 59 K.P si edhe aplikimi i nenit 63, pra pune në interes publik.

Jane ekzekutuar 2 urdhëra për denim me burgim të perjetshëm, 138 urdhëra për denimin me burgim, janë ende në ekzekutim 17 urdhëra për denimin me burgim dhe 80 për denimin e të pandehurve me gjobe.

NGARKESA E PUNËS PËR SECILIN PROKUROR.

Prokuror Spartak Cocoli

Në total Prokurori Spartak Cocoli ka hetuar 299 procedime penale me 129 të pandehur nga të cilët për 41 prej tyre është caktuar masa e sigurimi personal "Arrest në burg", nga të cilët 4 prej tyre janë në mungesë.

Jane dërguar për gjykim 112 procedime penale, janë pezulluar hetimet për 60 procedime penale, për 30 procedime penale janë pushuar hetimet, 7 procedime penale janë transferuar për kompetencë dhe 90 procedime penale janë mbartur për vitin 2016.

Nga përfaqësimi në gjykatë i çështjeve nga ana e këtij prokurori rezulton se nuk ka pafajsi. Është kërkuar tërheqja e akteve në një rast për hetime të metejshme.

Gjithashtu rezulton se pergjithesisht gjykata ka vendosur sipas kërkesave të prokurorit. Nuk ka patur ndryshime të cilesimit juridik në gjykatë..

Ankimet në gjykatën e apelit pergjithesisht kanë patur për objekt masën e denimit të caktuar nga Gjykata e shkallës së parë si dhe lidhur me masat e sigurimit. Jane bërë gjithsej 13 ankime në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Prokuror Julian ÇAFKA

Në total Prokurori Julian Çafka ka hetuar gjithsej 293 procedime penale me 116 të pandehur, nga të cilët për 16 prej tyre është caktuar masa e sigurimit personal "arrest në burg", nga të cilët 1 prej tyre ka qenë në mungesë

Janë dërguar për gjykim 83 procedime penale, janë pezulluar hetimet për 84 procedime penale, për 30 procedime penale janë pushuar hetimet, për 19 procedime është vendosur moskompetenca dhe 77 procedime penale janë mbartur për vitin 2016.

Nga përfaqësimi në gjykatë i çështjeve nga ana e këtij prokurori, rezulton se është marrë 1 pafajsi me 1 të pandehur në gjendje të lirë. Nuk është kërkuar tërheqja e akteve për hetime të metejshme.

Gjithashtu rezulton se përgjithësisht gjykata ka vendosur sipas kërkesave të prokurorit.

Cilësimet juridike të bëra në fazën e regjistrimit të hetimeve paraprahe janë konkluduar me ngritjes e akuzave sipas këtyre cilësimeve.

Nuk ka ndryshim të cilësimeve juridike nga gjykata. Ankimet në Gjykatën e Apelit Gjirokastër përgjithësisht kanë patur për objekt masën e dënimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë si dhe lidhur me masat e sigurimit. Janë bërë gjithsej 9(nëntë) ankime në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Ka patur edhe ankime të tjera të kryera kundër vendimeve të gjykatës e cila ka disponuar me prishje të vendimeve të mosfillimit të procedimit penal.

Nga viti 2014 janë mbartuar 73 procedime penale, me 37 të pandehur nga të cilët 17 kanë qenë me arrest në burg, 2 prej të cilëve në mungesë. Janë dërguar për gjykim 29 procedime penale me 33 të pandehur, janë pushuar 11 procedime dhe janë pezulluar hetimet për 17 procedime. Nga këto procedime janë marrë 2 pafajësi me 4 të pandehur në gjendje të lirë, shqyrtimi I të ankimit të të cilave nuk ka përfunduar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Prokuror Arian Muçaj

Prokurori Arian Muçaj është emëruar në detyrën e prokurorit Pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjirokastër në datën 04 qershor 2015

Procedimet penale të cilat janë rregjistruar dhe dorezuar për hetim pas emërimit të tij në këtë detyrë si edhe procedimet penale të cilat ju dorëzuan pas largimit të prokurorit Gjon Fusha i cili u emëruar me detyrë prokuror në prokurorinë e Apelit Gjirokastër janë : Gjithsej 183 procedime gjatë vitit 2015 nga të cilat 52 procedime për gjykim nga të cilat vetëm një pafajësi, 5 moskompetence, 53 pezulluar, 6 pushuar

Ne dore 67 procedime

Gjithsej 45 të pandehur me masa sigurimi nga të cilët :

1 arrest në burg në mungesë,

20 arrestuar në flagrancë dhe masë sigurimi arrest në burg,

21 arrestuar në flagrancë dhe masë sigurimi detyrim për paraqitje,

1 arrestuar në flagrancë dhe lirim i menjëhershëm,

2 ndalim dhe masë sigurimi arrest në burg

Nga çështjet e dërguara për gjykim nga ana e prokurorit Arian Muçaj vetëm për një procedim është dhënë pafajësi nga ana e gjykatës

Nuk ka pasur asnjë rast të ndryshimit të kualifikimit të gjykatës nga akuza që është dërguar nga prokurori

Përveç një ankimi në apel për pafajësi, ankimet e tjera janë bërë për masë dënimi si edhe në një rast për caktimin e masës së sigurimit. Gjithashtu janë bërë ankime për vendimet e gjykatës kundër vendimit të mosfillimit të procedimit

Prokuror Emror KASAJ

Ka hetuar **105** ceshtje penale, prej te cilave.

Ka hetuar **77** proçedime penale.

Me **10** të pandehur.

Per **9** te pandehur është caktuar masa e sigurimit personal “arrest në burg”.

3 persona me mase arresti kane qene në mungesë.

Janë dërguar për gjykim **4** proçedime penale,

Janë pezulluar hetimet për **39** proçedime penale (**35** prej tyre procedime qe lidhen me ceshtjen e fshatit Lazarat, ardhur nga Prok e Krimeve te Renda).

Janë pushuar hetimet për **4** proçedime penale (asnjera me te pandehur).

Janë mbartur për vitin 2016, **31** proçedime penale.

Nga përfaqësimi në gjykatë i çështjeve nga ana e këtij prokurori, rezulton se:

Nuk ka dosje te përfunduara ne gjykim.

Nuk është kërkuar tërheqja e akteve për hetime të mëtejshme.

Cilësimet juridike të bëra në fazën e regjistrimit hetimeve paraprake janë konkluduar me ngritjes e akuzave sipas këtyre cilësimeve.

Nuk ka ndryshim të cilësimeve juridike nga gjykata.

Ankimet në Gjykatën e Apelit Gjirokastër përgjithësisht kanë patur për objekt caktimin prej saj te masave te sigurimit.

Prokuror Arben PASHO

Gjate vitit 2015 ka patur ne hetim 49 procedime penale te rregjistruara nga te cilat

17 procedime penale jane derguar per gjykim me 21 te pandehur nga te cilet 10 hetuar dhe derguar per gjykim me mase sigurimi arrest ne burg, 2 me mase sigurimi arrest ne shtepi dhe 09 te pandehur me mas ate tjera.

Deklaruar fajtores 12 te pandehur.

Pushuar 09 procedime penale me tre persona nen hetim, asnje me mase sigurimi arrest ne burg

Pezulluar 06 procedime penale

Mbartuar per vitin 2016 18 procedime penale.

Ngarkesa e punes e Oficereve te Policise Gjqesore

Statistika për procedimet penale të hetuara nga oficeri i policisë gjyqësore Martin Pali për vitin 2015.

Në total, për vitin 2015 nga oficeri i policisë gjyqësore Martin Pali jane hetuar 52 procedime penale nga te cilat 17 janë të mbartura nga viti 2014, me 41 të pandehur nga të cilët 9 me masë sigurimi arrest në burg dhe 3 të pandehur me masë sigurimi arrest në shtëpi.

Nga oficeri i policisë gjyqësore janë raportuar për gjykim 29 procedime penale me 41 të pandehur nga të cilët 9 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg, 3 të pandehur me masë sigurimi arrest në shtëpi dhe 5 të pandehur hetuar e dërguar për gjykim në mungesë. Po kështu janë raportuar për pushim 10 procedime penale, për pezullim është raportuar për 3 procedime penale dhe për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda është raportuar për një procedim penal.

Mbetën në hetim 9 procedime penale.

Nga ana e Prokurorit të çështjes është vendosur mënyra e përfundimit të procedimeve penale si më sipër sipas relacionit të përpiluar nga ana e oficerit të policisë gjyqësore.

Nga oficeri i policisë gjyqësore Martin Pali është bërë njoftimi i akteve sipas kërkesave për ndihmë juridike nga autoritetet e huaja në çështjet penale në 7 raste.

O.P.GJ RIKARD LOLOCI

Per vitin 2015 nga oficeri policise gjyqesore Rikard Loloci jane hetuar 84 procedime penalenga te cilat 2 jane te mbartuara nga vitit 2014 me 57 te pandehur prej te cileve 16 me mase sigurimi arrest ne burg dhe 11 te pandehur me detyrim paraqitje.

Nga oficeri policise gjyqesore Rikard Loloci jane raportuar per gjykim 54 procedime penale me 57 te pandehur nga te cilet 16 me mase sigurimi arrest ne burg, 11 me detyrim paraqitje dhe 7 te pandehur ne mungese.

Po keshtu jane raportuar 8 procedime per pushim dhe 8 procedime per pezullim.

Mbeten nen hetim 14 procedime penale .

Per te gjitha procedimet e mesiperme te raportuara per pushim ,pezullim apo derguar per gjykim nga ana e prokurorit eshte vendosur sipas relacionit te përpiluar nga ana e oficerit te policise gjyqesore.

OP.GJ ÇLIRIM PUTO (Tatimeve)

Ne total nga oficeri i policise gjyqesore Çlirim Puto jane kryer veprime hetimore per, gjithsej 42 procedime penale, me 15 te pandehur, prej te cileve per 1 te pandehur eshte caktuar masa e sigurimit personal “arrest ne burg”.

Eshte sugjeruar per dergimin per gjykim per 15 procedime penale.

Eshte sugjeruar per pezullimin e hetimeve per 2 procedime penale.

Eshte sugjeruar per transferimin e 2 procedimeve penale

Eshte sugjeruar per pushimin e hetimeve per 15 procedime penale.

Jane mbartur per vitin 2016, 8 procedime penale.

Nuk ka raste, qe sugjerimet e dhena mbi menyren e perfundimit te hetimit te procedimeve penale, te kene pasur kundërshti nga prokurori i çështjes, apo qe zgjidhja perfundimtare per cdo procedim penal, te kete qene e ndryshme nga sugjerimi i dhene.

Per te gjitha rastet kur eshte sugjeruar dergimi i procedimit penal per gjykim, nuk ka pasur pafajesi, ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale, kthim te akteve nga gjykata, pavlefshmeri te akteve, etj.

Ne funksion te veprimeve hetimore te kryera, ka pasur ne total 12 zgjatje afati per procedimet ne hetim.

O.P.GJ GENI XHELILI (Dogana)

Ne total nga oficeri i policise gjyqesore Gentian Xhelili jane kryer veprime hetimore per, gjithsej 43 procedime penale, me 29 te pandehur, prej te cileve per 1 te pandehur eshte caktuar masa e sigurimit personal "arrest ne burg".

Eshte sugjeruar per dergimin per gjykim per 27 procedime penale.

Eshte sugjeruar per pezullimin e hetimeve per 7 procedime penale.

Eshte sugjeruar per pushimin e hetimeve per 9 procedime penale.

Jane mbartur per vitin 2016, 3 procedime penale.

Nuk ka raste, qe sugjerimet e dhena mbi menyren e perfundimit te hetimit te procedimeve penale, te kene pasur kundershiti nga prokurori i ceshtjes, apo qe zgjidhja perfundimtare per cdo procedim penal, te kete qene e ndryshme nga rekomandimi i dhene.

Per te gjitha rastet kur eshte sugjeruar dergimi i procedimit penal per gjykim, nuk ka pasur pafajesi, ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale, kthim te akteve nga gjykata, pavlefshmeri te akteve, etj.

Ne funksion te veprimeve hetimore te kryera, ka pasur ne total 6 zgjatje afati per procedimet ne hetim.

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Gjirokaster per vitin 2015 ka patur fonde buxhetore ne shumen totale 28 613 240 te realizuara keto ne ndarjen e Artikujve si me poshte :

600 "Paga te personelit te perhershme" ne Shumen 15 460 760

601 "Kontribute te sigurimeve shoqerore " ne Shumen 2 210 778

602 "Mallra e sherbime" 8 300 110

606/1001 "Ndihma ekonomike" 50 000

231 Shpenzime te lidhura me investimet ne Shumen 340 967 te cilat jane perdorur per "Rikonstruksion ambjentesh"

Aktivet e qendrueshme te trupezuara perbehen nga Mjete transporti me vleren 660 530 leke, ndertesa dhe truall ne vlerat 500 000 dhe 22,879,801 se bashku me godine e ish Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tepelene, dhe inventar ekonomik me vlere 15,484,422 leke .

Detyrimet per kete vit jane ne vleren 1 434 700 leke ku pjesen me te madhe e zene detyrimet per shpenzimet per honoraret ku perfishen shpenzimet per avokat, ekspert te ndryshem , perkthyes PMNZH etj.

Ne lidhje me furnizimin dhe harxhimin e karburantit per kete vit jane harxhuar 2350 litra mesatarisht nga 200 litra ne muaj per nje autoveture tip "BMW" X5

Struktura organike ne kete prokurori ka funksionuar sipas strukturese se derguar nga Prokuroria e Pergjithshme ne baze te urdherit nr.80, date 20.02.2015 te Prokurorit te Pergjithshem. Ndersa per periudhen ne vazhdim ndryshimet gjate vitit, shitesat ose pakesimet jane bere me urdher te Prokurorit te Pergjithshem, ne zbatim te nenit 8 te ligjit nr.8737, date 12.02.2001 " Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise"

Ne lidhje me ambientet e institucionit ne perdorim jane 10 zyra nga personeli dhe nje zyre perdoret per per arshiven e Prokurorise e cila nuk i permbush nevojat dhe funksionin e arshives (e pamjaftueshme hapesira).Gjithashtu nuk kemi nje ambient te pershatshem per mbajtjen e provave materiale.

MARRËDHENIET ME INSTITUCIONET E TJERA

Për vitin 2015 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë gjatë veprimtarisë të vetë përsa u përket marrëdhënieve me institucionet e tjera, me të cilët ndërvepron gjatë veprimtarisë procedurale, është karakterizuar nga korrektesa dhe një frymë bashkëpunimi në drejtim të zbatimit të ligjit. Kështu kjo gjë mund të thuhet për marrëdhëniet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, përsa u përket zhvillimit të seancave gjyqësore, korrektesës, etikës të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit, në drejtim të përmbushjes të detyrimeve ligjore.

Kjo frymë bashkëpunimi evidentohet dhe në marrëdhëniet me Drejtorinë e Policisë të Qarkut, Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, I.E.V.P.Tepelenë, Zyren Përmbarrimore, Gjykatën dhe Prokurorinë e Apelit , Zyren e Sherbimit te Proves etj.

PRIORITETET E PUNËS PËR VITIN 2016

Për vitin 2016 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë synon që të përqendrohet më tepër në goditjen e veprave penale që lidhen me veprat penale te Shpërdorimit te detyres dhe korrupsionit. Për këtë synohet një forcim i politikës penale përsa u përket masave të sigurimit ndaj të dyshuarëve si autorë të këtyre veprave por dhe masave të dënimit që do të kërkojnë për ta.

Njekohesisht prioritet është evidentimi rasteve te korrupsionit ne sistemin arsimor, pasi qartazi evidentohet se persona te caktuar jane futur brenda sistemit te administrates shtetore duke kaluar perms nje sistemi edukativ dhe mesimdhenes shume te dyshimte. Te gjithë kemi patur mundesine dhe kemi pervojen per te vleresuar demet e jashtezakoneshme qe i shkakton aparatit shtetoror por edhe interesave te qytetareve qenia ne sektoret e administrates shtetore te personave te pakualifikuar ose me kualifikim te dyshimte.

Gjithashtu gjatë këtij viti përsa i përket gjykimit synohet rritja e tregueseve për zhvillimin e gjykimeve të drejtëpërdrejta si dhe aplikimit në një masë më të lartë të dënimeve alternative dhe plotësuese.

Gjirokastrë më 19.01.2016

DREJTUESI I PROKURORISE

ARBEN PASHO